



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Skupstina Opštine
Municipal Istog

Drejtoria Komunale e Arsimit

05.Nr.392/26

Datë: 06.07.2026

Duke vepruar sipas shkresës Nr.ref.3/2838 të MASH të datës 29.06.2026, e bazuar në Ligjin Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr.04/L-138 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional e në lidhje me Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 për Numrin maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, e në mbështetje të Kornizës së Kurrikulit të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog , shpall:

K O N K U R S

Për regjistrim të nxënësve në klasat e 10 (dhjeta),viti shkollor 2026/2027, në Gjimnazin "Haxhi Zeka" në Istog, në IAAP "Mithat Frashëri" Gurrakoc dhe për kandidatët e intresuar në Qendrën Korrektuese në Dubravë , paralelja e IAAP-së "Rudina" Burgu i Dubravës.

Në klasën e dhjetë, në Gjimnazin "Haxhi Zeka" në Istog, sipas planit të regjistrimit për vitin shkollor 2026/2027, mund të regjistrohen 250 nxënës që do të shpërndahen në 10 (dhjetë) paralele.

a) Në drejtimin e shkencave natyrore 6 (gjashtë) paralele 150 nxënës

b) Në drejtimin e shkencave shoqërore 4 (kater) paralele 100 nxënës

Në IAAP "Mithat Frasheri" në Gurrakoc,sipas planit të regjistrimit për vitin shkollor 2026/2027,do të regjistrohen nxënësit si me poshtë:

Shkolla	Drejtimi	Profili	Nr.i paral.	Nr.i nxën.
"Mithat Frashëri"	Makineri, prodhimtari dhe ndërtimtari	Ditëgjimi kompjuterik i makinave	1	22
		Operator i prodhimit	1	22
		Metalpunues	1	20
		Automekanik	1	20
		Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit	1	20
		Instalues elektrik	1	20
	Teknologji e informacionit dhe komunikimit	Informatikë	1	22
		Telekomunikacion	1	22
	Shërbime	Asistent i mikpritjes hoteliere	1	20
	Shëndeti dhe mirëqenia	Bashkëpunëtor profesional i infermierisë	1	24
		Gjithsej në shkollën amë	10	212
Mithat Frsheri Rudina-Dubrave (Qendra Korrektuese)	Makineri, prodhimtari dhe ndërtimtari	Saldator	1	15
		Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit	1	15
		Gjithsejtë në paralelen e ndarë	2	30
		Gjithsej	12	242

- DKA-të të formojnë komisionet profesionale dhe përkatëse për regjistrimin dhe pranimin e nxënësve në klasën e dhjetë (X).
- MASH do të bëjë monitorimin e procesit të regjistrimit dhe pranimit të nxënësve.

Kriteret dhe kushtet për regjistrim për vitin shkollor 2026-2027:

- Shpallja e konkursit më datë **7.7.2026** nga DKA-të;
- Dorëzimi i dokumenteve më **7, 8 dhe 9** korrik 2026
- Shpallja e rezultateve më **10.07.2026**
- Shpallja e konkursit plotësues në muajin gusht për vendet e lira më datë **17.08.2026**
- Dorëzimi i dokumenteve për konkurs plotësues më datë **17, 18 dhe 19 gusht 2026**
- Shpallja e rezultateve për konkurs plotësues më **20.8.2026**

Konkursi shpallet edhe në gjuhët e komuniteteve në komunat ku organizohet mësimi për komunitete,

Konkursi shpallet bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional Nr. 04/L-138, si dhe në Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013, Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës.

Sqarim: Drejtimit për gjimnaze shpallen sipas Kornizës së Kurrikulit të Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (KKK).

Kushtet dhe kriteret:

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në gjimnaze dhe IAAP në vitin shkollor 2026-2027, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit të cilët e kanë mbaruar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë njohjen e dëftësive në MASH dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe IAAP, duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes

3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve në gjimnaze dhe IAAP për vitin shkollor 2026-2027, bëhet me datën 7, 8 dhe 9 korrik 2026, në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 10.07.2026.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës 11.07.2026.

Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar, ka të drejtë ankese brenda (2) dy ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve.

Ankesa parashitohet në drejtorinë e shkollës. Ankesat në shkallën e dytë behën në Drejtorinë Komunale të Arsimit brenda (2) dy ditë pune, pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kritere:

- | | |
|---|---------------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (40%) 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar | (20%) 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (40%) 40 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë (100 %), 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze dhe shkolla të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë minimum 4.00 (Së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç për klasat (6-9), pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve)

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është minimumi 40% i pikëve nga ato lëndë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\text{Suksesi (kl.6 + kl.7 + kl.8 + kl.9)} \times 2 = 40 \text{ pikë max}$$

Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë.

$$\text{mesatarja e lëndës (I)} + \text{mesatarja e lëndës (II)} + \text{mesatarja e lëndës (III)} + \text{mesatarja e lëndës (IV)} = 20 \text{ pikë max}$$

• Lëndët me prioritet në sukses sipas drejtimeve të gjimnazeve:

- a. Gjimnazi i shkencave natyrore: Fizikë, Kimi, Biologji, Matematikë

- b. Gjinnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore: Gjuhë amtare, Gjuhë angleze, Histori, Gjeografi

• **Lëndët me prioritet në sukses sipas profileve në IAA**

- a. **Shëndetësi, Bujqësi, Teknologji Ushqimore, dhe Veterinari:**
Biologji, Kimi, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi
- b. **Makineri, Elektroteknikë, TIK, Tekstil, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë, Komunikacion, Kimi – Teknologji, PTT:**
Matematikë, TIK, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi
- c. **Ekonomi, administratë:**
Matematikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjeografi
- d. **Juridik dhe administratë:**
Edukatë qytetare, Histori, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjeografi
- e. **Tregti, Hotelieri dhe Turizëm:**
Gjuhë shqipe dhe letërsi, Histori, Edukatë qytetare, Gjeografi
- f. **Shkollat Artistike:**
Gjuhë amtare dhe letërsi, Edukatë qytetare, Art, Muzikë
Drejtimi pedagogjik – profili bashkëpunëtor muzikor:
Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe testin kombëtar.
Drejtimi instrumental:
Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl. I-VII), në klasën e VII të shkollës së muzikës mund të regjistrohen vetëm nxënësit që kanë përfunduar shkollën e ulët të muzikës (kl. I-VI).
Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë – duhet t'i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

4. Kriteri i suksesit (notat) në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

- **Gjinnazi i shkencave natyrore - Mesatarja e lëndëve: fizikë, kimi, biologji dhe matematikë së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji),**

$$\frac{mes(Kimi) + mes(Biologji) + mes(Fizikë) + mes(Matematikë)}{4} \geq 4$$

- **Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore** - Mesatarja e lëndëve: gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori, gjeografi, së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (20 pikë nga lëndët gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori dhe gjeografi)

$$\frac{mes(Gjuhë_shqipe) + mes(Gjuhë_angleze) + mes(Histori) + mes(Gjeografi)}{4} \geq 4$$

- **Shkollat e Shëndetësisë** - Mesatarja e lëndëve: kimi, biologji, fizikë dhe gjuhë amtare së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët fizikë, kimi dhe biologji).

$$\frac{mes(Kimi) + mes(Biologji) + mes(Fizikë) + mes(Gjuhë_shqipe)}{4} \geq 4$$

B. Përmbajtja e testit – numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve:

I. Gjuhë

1. Gjuhë shqipe 20 pikë
2. Gjuhë angleze 5 pikë (Gjithsej 25 pikë)

II. Shkencat shoqërore:

1. Gjeografi 12 pikë
2. Histori 13 pikë
(Gjithsej 25 pikë)

III. Matematikë

1. Matematikë 20 pikë
2. Informatikë 5 pikë
(Gjithsej 25 pikë)

IV. Shkencat natyrore:

1. Fizikë 8 pikë
2. Kimi 8 pikë
3. Biologji 9 pikë (Gjithsej 25 pikë)

5. Renditja e lëndëve me përparësi në test sipas drejtimeve të gjimnazeve:

I. Gjimnazi shkencat e natyrës:

- | | |
|--|------------------------|
| 1. Shkencat e natyrës - 25 | 25x 0.8 = 20 pikë |
| 2. Matematikë dhe Informatikë - 25 | 25 x 0.4 = 10 pikë |
| 3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze - 25 | 25 x 0.3 = 7.5 pikë |
| 4. Shkencat shoqërore - 25 | 25 x 0.1 = 2.5 pikë |
| | Totali =40 pikë |

II. Gjinnazi shoqëror dhe gjuhësor:

- | | |
|--|----------------------------|
| 1. Shkenca shoqërore - 25 | $25 \times 0.6 = 15$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze - 25 | $25 \times 0.6 = 15$ pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë - 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkenca natyrore - 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| Totali = 40 pikë | |

6. Renditja e lëndëve me përparësi sipas profileve në IAAP

I. Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari

- | | |
|--|----------------------------|
| 1. Shkencat natyrore - 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze - 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë - 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkencat shoqërore - 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| Totali = 40 pikë | |

II. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi - Teknologji

- | | |
|--|----------------------------|
| 1. Matematikë dhe Informatikë - 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze - 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Shkenca natyrore - 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkenca shoqërore - 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| Totali = 40 pikë | |

III. Ekonomi

- | | |
|--|----------------------------|
| 1. Matematikë dhe Informatikë - 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze - 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Shkenca shoqërore - 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkencat natyrore - 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| Totali = 40 pikë | |

IV. Juridik

- | | |
|--|----------------------------|
| 1. Shkencat shoqërore - 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze - 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë - 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkenca natyrore - 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| Totali = 40 pikë | |

V. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm

- | | |
|--|----------------------------|
| 1. Gjuhë amtare dhe Gjuhë angleze - 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Shkenca shoqërore - 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë - 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkenca natyrore - 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| Totali = 40 pikë | |

Pranimin e dokumentacioneve do ta bëjë komisioni i themeluar në kuadër të shkollave përkatëse.



*Drejtori i DKA-së
Naim Behlulaj*

Behlulaj